



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:204837

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06531507

C-III-22-0308

Paditësi

Sh L nga Podujeva, të cilin e përfaqëson avokat V B, nga Prishtina.

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit-(AKP), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Agron Hoxhaj gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 2 dhjetor 2024, merr këtë:

AKTVENDIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit për lëshimin e masës së sigurisë lidhur me ngastrën kadastrale ., pjesën në sipërfaqe prej 00.05.27 ha, zona kadastrale Ç**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 4 Nëntor 2022, pranë DHPGJS paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, parashtron një padi, me të cilën kërkoj që ti njihet e drejta e pronësisë së një pjese të ngastrës kadastrale nr. ., në sipërfaqe prej 00.05.27 ha, zona kadastrale Ç (në tekstin në vijim PRONA KONTESTUESE).

Paditësi të drejtën e tij pronësore, në PRONËN KONTESTUESE, e mbështetë në Vendimin e Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) – publike informative, Radio Televizioni i Prishtinës (në tekstin në vijim RTP) si dhe Kontratën mbi dhënien e PRONËS KONTESTUESE në pronësi, kontratë kjo e lidhur mes paditësit dhe RTP.

Paditësi pohon se e drejta mbi PRONËN KONTESTUESE është fituar si rezultat i kompensimit nga ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Padisë i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,

- Kopja e Vendimit nr. 02/16./15/99 datë 28 korrik 1999, mbi ndarjen e PRONËS KONTESTUESE,
- Kopja e Kontratës mbi dhënien e patundshmërisë në pronësi, e lidhur mes paditësit dhe RTP, nr.,
- Kopja e Vendimit nr. 04/68/10/012 datë 29 tetor 2012,
- Kopja e fletës poseduese, nr., të ngastrave kadastrale nr. . dhe., e evidentuar në emër të RTP, e lëshuar me . qershor ., dhe
- Kopja e planit, të ngastrave kadastrale nr. . dhe ..

Me 25 tetor 2024, paditësi parashtron propozim mbi caktimin e Masës së Sigurisë (në tekstin në vijim MS), të PRONËS KONTESTUESE, ashtu që kërkoj nga gjykata që të ndalohet tenderimi, privatizimi dhe çfarëdo forme tjetër e tjetërsimit të PRONËS KONTESTUESE gjer në vendimin përfundimtar të gjykatës lidhur me çështjen.

Me propozim u parashtruan kopjet e njëjta të dëshmive si ato me padi.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 20 nëntor 2024 parashtron përgjigjen ndaj propozimit mbi lëshimin e MS.

AKP kundërshton padinë me propozimin mbi lëshimin e MS duke e konsideruar si të pabazuar. AKP fillimisht konsideron se dëshmitë e parashtruara, nga paditësi, janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për DHPGJS. Tutje, AKP, konsideron se dhënia në pronësi apo shfrytëzim e PRONËS KONTESTUESE, është bërë në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, ku thuhet se me të gjitha pronat publike dhe shoqërore në Kosovë administron UNMIK-u. AKP konsideron se padia e paditësit nuk përmban argumentet ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore dhe se lidhur me dëmin e shkaktuar, mbi humbjen e shkaktuar të punës nuk mund të jetë përgjegjëse NSH por përgjegjësia bie mbi organet e atëhershme të dhunshme. Lidhur me dëmin e shkaktuar, paditësit, AKP i referohet dispozitave ligjore të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve. AKP gjithashtu konsideron se i mungon legjitimiteti real-pasiv. AKP përfundimisht qëndron pranë asaj se nuk janë plotësuar kushtet mbi lëshimin e MS, ashtu siç parashihet sipas nenit 61 të Ligjit për DHPGJS andaj i propozon gjykatës që MS të refuzohet si e pabazuar.

AKP, me 27 nëntor 2024, parashtron përgjigjen në padi.

Arsyetimi ligjor:

Në pajtim të nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS mund të nxjerrë MS me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një MS. Sipas nenit 61.1, dëmi konsiderohet si i ‘pariparueshëm’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bie mbi paditësin.

Andaj, pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonin lëshimin e MS. Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrojë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm do të shkaktohej në qoftë se MS nuk do të lëshohej.

Kërkesa për lëshimin e MS nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS.

Nga të gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Paditësi ka paguar taksat gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i mbulon shpenzimet e veta.

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues _____

Diellza Hoxha, Gjyqtare _____

Agron Hoxhaj, Gjyqtar _____